



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1482 prot.

Tiranë më, 24.05.2019

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr. 02, datë 24.05.2019

**PËR**

**ZBATIMIN E LIGJIT LIDHUR ME REGJIMIN E POSAÇËM NË BURGUN E  
SIGURISË SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 148 pika 1<sup>1</sup>, 148/b shkronja "b"<sup>2</sup>, 148/dh pika 1, 135 pika 2 dhe 179 pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat "b", 46 pika 3 shkronja "b", 109 pika 3 dhe 110 të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neneve 8, 9 e 57 pika 5 të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", neneve 162 e 163 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenet 75/a, 471 e 480 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me nenin 285 pika 4 të ligjit nr.35/2017 "Për ndryshimin e ligjit nr.7905/1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë" dhe me nenin 13/1 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, si dhe në vendimin njësues nr.13 datë 04.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

<sup>1</sup> Shih, nenin 148 pika 1 të Kushtetutës, që parashikon: "1.... Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.";

<sup>2</sup> Shih, nenin 148 shkronja "b" e Kushtetutës dhe nenet nenin 38 pika 2 shkronja "b" në lidhje me nenin 46 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikojnë:

-Neni 148 shkronja "b" e Kushtetutës parashikon: "Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme";

-Neni 38 pika 2 shkronja "b" e ligjit nr.97/2016 parashikon: "2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre";

-Neni 46 pika 3 shkronja "b" e ligjit nr.97/2018 parashikon: "3. Prokurori i Përgjithshëm mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme: b) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore;"

Me synim, unifikimin e zbatimit të ligjit<sup>3</sup> lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për të garantuar ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në këto institucione të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) dhe/ose rritjen e efektivitetit në parandalimin e komunikimit të dënuarve apo të paraburgosurve me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata kriminale të tjera;

## UDHËZOJ:

### Neni 1

#### Kompetencat e drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda në periudhën kalimtare

1. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda<sup>4</sup> (në vijim drejtuesi i PKR), deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, në rastet e veçanta sipas

<sup>3</sup> Shih, ligjin nr.8328/1998, i ndryshuar me ligjin nr. 108/2018, datë 20.12.2018, hyre në fuqi me datë 31.01.2019, FZ Nr.197 e vitit 2018.

<sup>4</sup> Shih, nenet 148/dh pika 1, 135 pika 2 e 179 pika 8 të Kushtetutës, neni 110 të ligjit nr. 97/2016, nenet 8, 9 e 57 pika 5 të ligjit nr. 95/2016, nenet 162 e 163 të ligjit nr. 96/2016, neni 75/a, 471 e 480 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me nenin 285 pika 4 të ligjit nr.35/2017 “Për ndryshimin e ligjit nr.7905/1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë” dhe me nenin 13/1 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, si dhe në vendimin njësores nr.13 datë 04.04.2018 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që parashikojnë:

- Shih neni 148/dh pika 1 i Kushtetutës parashikon: “1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë.”;

- Shih neni 135 pika 2 po aty parashikon: “2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, ...”

- Shih neni 179 pika 8 po aty parashikon: “8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krime të Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.”

-Shih neni 110 i ligjit nr.97/2016, parashikon: “Prokurorët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë u nënshtrohen dispozitave të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Shih neni 8 pika 2 në lidhje me pikën 1 të tij i ligjit nr. 95/2016, parashikon: “2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni...-Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale -...”

- Shih neni 9 pika 1 po aty, parashikon: “1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.”;

- Shih neni 57 pika 5 po aty parashikon: “5. Deri në fillimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme, kompetenca e saj për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për veprat penale apo subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 135, të Kushtetutës, ushtrohet përkatësisht nga Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore apo Prokuroria e Krimeve të Rënda, sipas kompetencës dhe juridiksionit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ditën e fillimit të funksionit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet nën hetim apo gjykim i transferohen menjëherë për ndjekje kësaj prokurorie.”

- Shih neni 162 pika 1 i ligjit nr. 96/2016 që parashikon: “1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të



kritereve të përcaktuara në ligj<sup>5</sup>, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, me kërkesë të arsyetuar i kërkon Ministrit të Drejtësisë vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë<sup>6</sup>.

2. Në rastet kur pas një periudhe një vjeçare, drejtuesi i PKR, bazuar në të dhënat/informacionet e institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, rivlerëson se ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj<sup>7</sup>, me kërkesë të arsyetuar i propozon Ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e regjimit të posaçëm ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit<sup>8</sup>.

---

*gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

- neni 163 pika 1 po aty, qe parashikon: "1. Prokurori në detyrë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë ose të Apelit qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

-Shih neni 75/a në shkronjat "a" e "b" të K.Pr.Penale parashikon: "Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;";

-Shih neni 285 pikat 4 e 5 të ligjit nr.35/2017 që parashikojnë: "4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ..., sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. 5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj...";

-Shih vendimin njëses i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.13 datë 04.04.2018, i cili ka analizuar dhe interpretuar dispozitat kushtetuese e ligjore të cituara më sipër dhe ka njëzuar praktikën gjyqësore edhe lidhur me kompetencën e prokurorisë për krime të rënda në periudhën kalimtare, duke përcaktuar: "Për të gjitha çështjet që rrjedhin nga hetimi apo gjykimi i veprave penale të listuara në nenin 75/a të pandryshuar të Kodit të Procedurës Penale, procedimi i të cilave është regjistruar në prokurori apo në gjykatë..., ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq do të jetë në kompetencën lëndore të prokurorisë për krimet e rënda. Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha çështjet penale të listuara në nenin 135 pika 2 të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9 të Ligjit nr. 95/2016 dhe nenin 75/a të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale, që janë tek prokuroritë e krimeve të rënda, pavarësisht fazës dhe gjendjes së procedimit, do të kalojnë nëpërmjet transferimit tek Prokuroria e Posaçme."

<sup>5</sup> Shih, pikën 1 të nenit 13/1 "Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë" të ligjit nr.8328/1998 i ndryshuar me ligjin nr.108/2018 që parashikon: "1. Në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të këtij neni, një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave mund zbatohet për të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 79, shkronja "ç", 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste."

<sup>6</sup> Shih, po aty pikën 2 të nenit 13/1 që parashikon:

"2. Vendimi për vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë merret nga Ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë."

<sup>7</sup> Shih, po aty pikën 1 të nenit 13/1;

<sup>8</sup> Shih, po aty pikën 5 të nenit 13/1 që parashikon:

## Neni 2

### **Kompetenca me krijimin e prokurorisë së posaçme**

Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, të gjitha praktikat dhe aktet e nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe ligjeve referuese<sup>9</sup>, që janë tek prokuroria e krimeve të rënda, pavarësisht fazës dhe gjendjes së akteve, do të kalojnë nëpërmjet transferimit tek Prokuroria e Posaçme.

## Neni 3

### **Zbatimi**

Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet drejtuesi i PKR dhe me mbikëqyrjen e zbatimit të tij ngarkohet drejtuesi i strukturës përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

## Neni 4

### **Hyrja në fuqi dhe shfuqizimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet<sup>10</sup> në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.
2. Në datën e krijimit të Prokurorisë së Posaçme ky udhëzim shfuqizohet.

## **PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA MARKU**



---

*“5. Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë është një vit. Me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, pas një periudhe njëvjeçare, Ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të rivlerësojë nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit”*

<sup>9</sup> Shih, nenin 135 pika 2 të Kushtetutës, nenin 8 dhe 9 të ligjit nr. 95/2016, nenin 75/a të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 285 pika 5 të ligjit nr.35/2017, te cituar mesiper;

<sup>10</sup> Shih, nenin 46 pika 5 të ligjit nr.97/2016;

---